



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.1090/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e paraqitur nga Hazir Luta, kandidat për Kuvendin Komunal në Rahovec, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, dega në Rahovec, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Hidhen të parregullt** apelet me numër Anr.1090/2021, Anr.1094/2021 të datës 08.11.2021, i paraqitur nga Hazir Luta, kandidat për Kuvendin Komunal në Rahovec, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, dega në Rahovec, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në Vendvotimin me nr. 1632A/01R, 1632A/02D, 1601A/01R, 1610A/02R, 1610A/03R, 1610A/04D.

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 08.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1090/2021, Anr.1094/2021 (përmes postës të datës 04.11.2021) të paraqitur nga Hazir Luta, kandidat për Kuvendin Komunal në Rahovec, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, dega në Rahovec, me të cilën pretendon se në qendrat e votimit 1632A/01R, 1632A/02D, 1601A/01R, 1610A/02R, 1610A/03R, 1610A/04D, ka mos përputhje të votave ngase siç pretendon në këto vendvotime kanë votuar familjaret dhe sipas informatave nuk figurojnë këto vota.

### **Paneli, pasi që vlerësoj apelin gjeti se i njëjti është i parregullt, për këto arsye:**

Paneli duke vepruar konform Rregullës Nr. 02/2015 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, përkatësisht në bazë të nenit 13.2 *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të apeleve, kryesuesi i panelit vendim marrës mund të vendosë ta bëjë bashkimin e apeleve që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim”* ka bashkuar apelet Anr.1090/2021, Anr.1094/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim, i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se apelet e paraqitura, janë të parregullta, pasi që Apeli i paraqitur në PZAP nga Hazir Luta, nuk i plotëson kushtet ashtu siç parashihet në nenin 10.6 dhe 7 të Rregullores nr .07/2015 për rregullat dhe procedurat PZAP –it ku “Apelet duhet të dorëzohen me shkrim e të jenë të nënshkruar nga ana e parashtruesi i apelit, apo në emër të tij nga personi i autorizuar, në rastet kur parashtruesi i apelit/ankuesi-ja, është parti politike, koalicion, iniciativë qytetare, ose çfarëdo personi tjetër juridik, apeli duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i atij personi juridik siç është përcaktuar në rastet ku kjo është e mundshme në çfarëdo dispozite ligjor në fuqi” dhe “Personi që e dorëzon apelimin duhet të përdorë formularin e gatshëm për apelim”. Të gjitha apelimet duhet të kenë së paku informacionet vijuese:

- a) emrin, adresën dhe informacionet për kontaktim të personit që e dorëzon apelimin
- b) arsyen për dorëzimin e apelimt
- c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të personit që e dorëzon apelimin apo udhëzimin se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të parashtruesit të apelimt
- d) vërtetimin nga personi që e dorëzon apelimin lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së apelimt.

Në rastin konkret parashtruesi i apelit nuk e ka nënshkruar formularin e apelit dhe hudhet i pa rregullt.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në vlerësimin e meritave të apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartcekur. PZAP, në këtë fazë që gjendet procesi zgjedhor, nuk mund të merr vendim tjetër sepse fillimisht parashtruesi i apelit nuk i plotëson kriteret për të ushtruar apel në PZAP, ashtu siç u vlerësua më lartë. Për këto arsye Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e lartcekura e në mbështetje të dispozitave të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr. 1090/2021 më datën 09.11.2021

**Kryesuesi i Panelit**

Burim Ademi

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së pranimt të këtij vendimi.

